



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 56

21 maj

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 252, datë 12.4.2012	Për miratimin e marrëveshjes së financimit dhe të projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave e ujësjellës-kanalizime, Korçë, si agjencia e zbatimit të projektit dhe KFW Frankfurt Am Main, për financimin e projektit “Korça IV” (fondet e grandit IPA).....	2807
Vendim i KM nr. 253, datë 12.4.2012	Për disa shtesa në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar.....	2817
Vendim i KM nr. 256, datë 12.4.2012	Për disa ndryshime në vendimin nr. 652, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve “Master i shkencave”/“Master i arteve të bukura”, për vitin akademik 2011- 2012”, të ndryshuar.....	2818
Vendim i KM nr. 257, datë 12.4.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit, të z. Mehmet Xheka.....	2819
Vendim i KM nr. 258, datë 12.4.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Klodian Seferaj.....	2819
Vendim i KM nr. 259, datë 12.4.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z.Rezar Veseli.....	2820
Vendim i KM nr. 260, datë 12.4.2012	Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve të dhëna sipas marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB), për financimin e programit të reformës së Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, faza I.....	2820

Vendim i KM nr. 262, datë 13.3.2012	Për disa shtesa në vendimin nr. 933, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave të shqyrtimit administrativ të kërkesave dhe masës së dëmshpërblimit financiar për familjarët e viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991”.....	2821
Vendim i KM nr. 263, datë 12.4.2012	Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për bashkëpunimin ndërmjet mekanizmeve institucionale dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.....	2821
Vendim i KM nr. 264, datë 12.4.2012	Për procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të vendosjes së sanksionit nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.....	2823
Vendim i KM nr. 265, datë 12.4.2012	Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore, përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij.....	2826
Vendim i KM nr. 266, datë 12.4.2012	Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmeve në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.....	2830
Vendim i KM nr. 268, datë 18.4.2012	Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të dhënies së koncesionit.....	2832
Vendim i KM nr. 269, datë 18.4.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, të ndryshuar.....	2833
Vendim i KM nr. 271, datë 18.4.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës”, të ndryshuar.....	2834
Vendim i KM nr. 272, datë 18.4.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Lukovë, të qarkut të Vlorës.....	2834
Vendim i KM nr. 273, datë 18.4.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Pishaj, të qarkut të Elbasanit.....	2835
Vendim i KM nr. 274, datë 18.4.2012	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës hyrëse të shkollës 9-vjeçare Bilaj, në komunën e Bubqit, të qarkut të Durrësit.....	2836
Vendim i KM nr. 275, datë 18.4.2012	Për dhënien e lejes së hyrjes dhe të qëndrimit të përkohshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë të një force ushtarake amerikane.....	2837
Vendim i KM nr. 276, datë 18.4.2012	Për disa shtesa në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 256, datë 12.3.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike në territorin administrativ të komunës Pajovë, të qarkut Elbasan” dhe nr. 988, datë 2.7.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pyjeve dhe kullotave, që transferohen në pronësi të komunës Pajovë të qarkut Elbasan”.....	2838
Vendim i KM nr. 277, datë 18.4.2012	Për autorizimin e “AMA RECYCLING”, sh.p.k. për importin e mbetjeve metalike të aluminit dhe të bakrit, për qëllime riciklimi....	2839

VENDIM
Nr. 252, datë 12.4.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT DHE TË PROJEKTIT, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE E
UJËSJELLËS-KANALIZIME, KORÇË, SI AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT DHE
KFW FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “KORÇA IV”
(FONDET E GRANDIT IPA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit dhe të projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ujësjellës-Kanalizime, Korçë, si agjencia e zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Korça IV” (fondet e grandit IPA), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJA E FINANCIMIT
DHE E PROJEKTIT NDËRMJET KFW, FRANKFURT MBI MAIN (KFW) DHE REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË (MARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, TIRANË DHE
UJËSJELLËS-KANALIZIME KORÇË (UKKO), KORÇË (AGJENCIA E EKZEKUTIMIT TË
PROJEKTIT), PËR 4,018,000 EURO (FONDET E GRANDIT IPA 2010)
KORÇË IV, FONDET IPA 2020 60 408

Preambul

Mbi bazën e një marrëveshjeje kontributi të datës 30.6.2011, midis Komisionit Europian, Këshillit të Bankës Europiane për Zhvillim dhe KfW (marrëveshja e kontributit), marrësi, agjencia e ekzekutimit të projektit dhe KfW nënshkruajnë marrëveshjen financiare si më poshtë:

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar

1.1 KfW do t'i japë marrësit një kontribut financiar që nuk i tejkalon 4,018,000 euro.

Ky kontribut financiar nuk do të jetë i riparueshëm, me përjashtim të parashikimit ndryshe nga neni 4.2.

1.2 Marrësi do ta kanalizojë plotësisht kontributin financiar tek agjencia e ekzekutimit të projektit në përputhje me kushtet e parashikuara nga neni 2. Agjencia e ekzekutimit të projektit ta përdorë kontributin financiar ekskluzivisht për ndërtimin e rrjetit dytësor të kanalizimeve (projekti). Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, agjencia e ekzekutimit të projektit dhe KfW do të përcaktojnë detajet e projektit, si dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga kontributi financiar me një amendim të marrëveshjes së veçantë të marrëveshjes së kredisë dhe të projektit të datës 8.10.2008, për të cilën duhet të bjerë dakord marrësi, përfaqësuar nga Ministria e Financave.



1.3 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që do të përballohen nga marrësi ose agjencia e ekzekutimit të projektit dhe tatimet e importit nuk do të financohen nga kontributi financiar.

Neni 2

Kanalizimi i kontributit financiar tek agjencia e ekzekutimit të projektit

2.1 Marrësi do ta kanalizojë kontributin financiar tek agjencia e ekzekutimit të projektit si grand i paripagueshëm sipas një marrëveshjeje të veçantë financiare.

2.2 Përpara disbursimit të parë nga kontributi financiar, marrësi do t'i dërgojë KfW-së një përkthim të certifikuar në anglisht ose gjermanisht të marrëveshjes së specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i kontributit financiar nuk do të përbëjë ndonjë detyrim të agjencisë së ekzekutimit të projektit për detyrimet e pagesës sipas kësaj marrëveshjeje.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW do ta disbursojë kontributin financiar në përputhje me progresin e projektit dhe me kërkesën e agjencisë së ekzekutimit të projektit. Me një amendim të marrëveshjes së veçantë të marrëveshjes së kredisë dhe të projektit të datës 8.10.2008, për të cilën duhet të bjerë dakord marrësi, përfaqësuar nga Ministria e Financave. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, agjencia e ekzekutimit të projektit dhe KfW do të përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti provat që tregojnë se fondet e disbursuara po përdoren për qëllimin e parashikuar.

3.2 KfW do të ketë të drejtën që të refuzojë kryerjen e disbursimeve pas datës 31 dhjetor 2014.

Neni 4

Pezullimi i disbursimeve dhe ripagesa

4.1 KfW nuk mund të pezullojë disbursimet me përjashtim të rastit kur:

a) Marrësi nuk arrin t'i kryejë detyrimet ndaj KfW-së për të bërë pagesat në afat;

b) Janë shkelur detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje ose sipas marrëveshjes së kredisë dhe projektit të datës 8.10.2008 për këtë projekt ose sipas marrëveshjeve të veçanta, që u përkasin njëres prej këtyre marrëveshjeve;

c) Agjencia e ekzekutimit të projektit nuk është në gjendje që të provojë se kontributi financiar është përdorur për qëllimin e parashikuar; ose

d) Lindin rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë rëndë implementimin, operimin ose qëllimin e projektit;

e) Komisioni Europian i kërkon KfW-së që t'i pezullojë disbursimet.

4.2 Në qoftë se ndonjë nga situatat e specifikuara në nenin 4.1 (b) ose (c) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW, e cila, sidoqoftë do të jetë të paktën 30 ditë, KfW:

a) Në rastin e nenit 4.1 (b), mund të kërkojë ripagesën e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara brenda 10 ditëve bankare;

b) Në rastin e nenit 4.1 (c), mund të kërkojë ripagesën e menjëhershme të atyre shumave të cilat agjencia e ekzekutimit të projektit nuk është në gjendje t'i provojë se janë përdorur për qëllimin e parashikuar brenda 10 ditëve bankare.

Neni 5

Kostot dhe detyrimet publike

Marrësi do t'i përballojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që mblidhen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë në lidhje me përfundimin dhe ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje, si dhe kostot e transferimit dhe shkëmbimit që lindin në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

Neni 6

Deklaratat kontraktuale dhe tagrat e përfaqësimit

6.1 Ministri i Financave dhe ata persona që emërohen prej tij te KfW-ja dhe autorizohen me nënshkrime specimene të vërtetuara prej tij do të përfaqësojnë marrësin në ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje. Drejtori i Ujësjiellës-Kanalizimeve, Korçë (UKKO) dhe ata persona të emëruar prej tij në KfW dhe të autorizuar me nënshkrime specimene të vërtetuara prej saj do të përfaqësojnë agjencinë e ekzekutimit të projektit në ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje. Tagrat e përfaqësimit nuk do të skadojnë deri në revokimin e shprehur të tyre nga përfaqësuesi i marrësit të autorizuar në kohën e marrjes nga KfW-ja.

6.2 Amendimet ose shtesat në këtë marrëveshje dhe çdo njoftim dhe deklaratë e dhënë nga palët kontraktuese sipas kësaj marrëveshjeje do të jenë me shkrim. Çdo njoftim ose deklaratë e tillë do të merret kur të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës korresponduese kontraktuese ose në ndonjë adresë tjetër të palës korresponduese kontraktuese siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW:

KfW

Department: L3a4 - Municipal Infrastructure
Southeast Europe and Turkey
Palmengartenstrasse 5 - 9
60325 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Fax: +4969 7431-2944

Për marrësin:

Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Faks: +355-4-222 84 94

Për agjencinë e
ekzekutimit të projektit

Ndërmarrja e Ujësjiellës-Kanalizimeve, Korçë (UKKO)
Rr. "Unaza e Qytetit", rajoni nr. 2
Korçë/Shqipëri
Fax: +355 82 82 457 59

6.3 Amendimet e kësaj marrëveshjeje financimi që ndikojnë vetëm në marrëdhëniet ligjore midis KfW-së dhe marrësit nuk do të kërkojnë pëlqimin e agjencisë ekzekutuese të projektit.

Neni 7

Projekti

7.1 Agjencia e ekzekutimit të projektit:

a) do të përgatisë, do të implementojë, do të vërë në punë dhe do të mirëmbajë projektin në përputhje me praktikën e shëndosha financiare dhe inxhinierike dhe në përputhje substanciale me konceptimin e projektit, siç është rënë dakord midis agjencisë së ekzekutimit të projektit dhe KfW-së;

b) do t'ua transferojë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të projektit inxhinierëve konsulentë të pavarur, të kualifikuar dhe implementimin e projektit firmave të kualifikuara;



c) do t'ua japë kontratat për mallrat dhe për shërbimet që do të financohen nga kontributi financiar me ofertim konkurrues ndërkombëtar paraprak;

d) do të mbajë ose do të bëjë që të mbahen librat dhe të dhënat që tregojnë në mënyrë të qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve që kërkohen për projektin dhe të identifikojë qartësisht mallrat dhe shërbimet e financuara nga kontributi financiar;

e) do t'u mundësojë përfaqësuesve të KfW-së në çdo kohë që të inspektojnë librat dhe të dhënat e lartpërmendura dhe çdo dokumentacion tjetër që lidhet me implementimin dhe vënien në punë të projektit dhe do të vizitojë projektin dhe të gjitha instalimet që lidhen me të;

f) do t'i japë KfW-së të gjitha informacionet dhe raportet për projektin dhe progresin e tij të mëtejshëm sipas kërkesës së KfW;

g) do t'i japë KfW-së të gjitha informacionet dhe raportet për projektin dhe progresin e tij të mëtejshëm sipas kërkesës së KfW-së. Marrësi njih të drejtën e Komisionit Europian që të përdorë pa pagesë dhe si ta shikojë të përshtatshme të gjitha dokumentet që janë financuar nga ky kontribut financiar;

h) do të sigurojë që të gjitha publikimet ose informacionet e tjera proporcionale për projektin të përfshijnë një referim për faktin që projekti bashkëfinancohet nga Bashkimi Europian dhe të tregojë logon europiane (dymbëdhjetë yje të verdhë në një sfond blu);

i) do të pranojë vizitat për vlerësimet dhe për monitorim nga përfaqësuesit e Komisionit Europian dhe/ose delegacioni i Komisionit Europian në Republikën e Shqipërisë;

j) do të sigurojë që për një periudhë deri në pesë vjet pas përfundimit të projektit, Komisioni Europian dhe Gjykata Europiane e Audituesve të jetë në gjendje të kryejë auditet e nevojshme për të verifikuar përdorimin e kontributit financiar, mbi bazën e dokumenteve dhe në vend, duke përfshirë të gjitha kontratat dhe nënkontratat që janë financuar me kontributin financiar. Komisioni Europian dhe Gjykata Europiane e Audituesve do të kenë të drejtën që të dërgojnë agjentët e tyre për të kryer në vend kontrolle dhe inspektime siç parashikon rregullorja (EC, Euroatom) nr. 2185/1996.

7.2 Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, agjencia e ekzekutimit të projektit dhe KfW do të përcaktojnë detajet që lidhen me nenin 7.1 me një amendament të marrëveshjes së veçantë për marrëveshjen e kredisë dhe të projektit të datës 8.10.2008.

7.3 Marrësi dhe agjencia e ekzekutimit të projektit:

a) do të sigurojnë financimin e plotë të projektit dhe me kërkesën e saj, do t'i japin KfW-së prova që tregojnë se janë mbuluar kostot e paguara nga ky kontribut financiar; dhe

b) nga ana e tyre ta informojnë menjëherë KfW për çdo rrethanë që përjashton ose rrezikon rëndë implementimin, vënien në punë ose qëllimin e projektit.

7.4 Marrësi dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit do të ndihmojnë agjencinë e ekzekutimit të projektit në përputhje me praktikën e shëndosha inxhinierike dhe financiare për implementimin e projektit dhe për përmbushjen e detyrimeve të agjencisë së ekzekutimit të projektit sipas kësaj marrëveshjeje dhe në veçanti, dhënien e të gjitha lejeve të nevojshme agjencisë së ekzekutimit të projektit për implementimin e projektit.

Neni 8

Dispozita të ndryshme

8.1 Marrësi, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe agjencia e ekzekutimit të projektit do të sigurojnë që personat e ngarkuar me përgatitjen dhe implementimin e projektit, dhënien e çdo kontrate për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen dhe që do të kërkojnë disbursime të shumave të kontributit financiar, të mos kërkojnë, të mos marrin përsipër, të mos japin, të mos premtojnë apo të marrin ndonjë premtim të pagesave të paligjshme apo të avantazheve të tjera në lidhje me këto detyra.

8.2 Agjencia e ekzekutimit të projektit do t'i vërë në dispozicion menjëherë KfW-së me kërkesën e saj të gjithë informacionin dhe dokumentet që KfW-ja kërkon për të përmbushur detyrimet e saj për të

parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me agjencinë e ekzekutimit të projektit që është e nevojshme për këtë qëllim.

Duke nënshkruar dhe implementuar këtë marrëveshje financimi, agjencia e ekzekutimit të projektit vepron në emrin e saj dhe për llogari të saj. Në lidhje me ligjin gjerman apo ligjin e vendit të themelimit të agjencisë së ekzekutimit të projektit:

a) burimet ose shumat që agjencia e ekzekutimit të projektit investon në financimin e projektit nuk do të jenë me origjinë të paligjshme dhe në veçanti, dhe duke mos qenë kjo listë shteruese, nuk do të lidhen me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin kriminal të organizuar apo terrorizmin;

b) kapitali i aksionarëve të agjencisë ekzekutuese të projektit asnjëherë nuk do të jetë me origjinë të paligjshme dhe në veçanti, duke mos qenë shteruese kjo listë, asnjëherë nuk do të lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, krimin e organizuar apo terrorizmin;

c) agjencia e ekzekutimit të projektit nuk do të angazhohet në blerjen, posedimin ose përdorimin e pronës që është me origjinë të paligjshme dhe në veçanti, duke mos qenë kjo listë shteruese, asnjëherë nuk do të lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, krimin e organizuar ose terrorizmin; dhe

d) agjencia e ekzekutimit të projektit nuk do të angazhohet në financimin e terrorizmit.

8.3 Në qoftë se ndonjë prej dispozitave të kësaj marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat do të mbeten të paprekura prej saj. Çdo boshllëk që krijohet prej saj do të mbushet nga një dispozitë në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshjeje.

8.4 Marrësi dhe agjencia e ekzekutimit të projektit nuk mund të caktojnë ose të transferojnë, të lënë peng apo të hipotekojnë ndonjë pretendim nga kjo marrëveshje.

8.5 Kjo marrëveshje do të rregullohet nga ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i kryerjes do të jetë Frankfurt mbi Main.

8.6 Marrëdhëniet ligjore të vendosura nga kjo marrëveshje midis KfW-së dhe marrësit dhe agjencisë së ekzekutimit të projektit do të ndërpriten me fundin e jetës së dobishme të projektit, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë vjet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

U bë në 3 origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt mbi Main [për t'u plotësuar]

KfW

Nga:

Emri:

Titulli:

Nga:

Emri:

Titulli:

Tiranë [për t'u plotësuar]

Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Financave

Nga:

Emri: Ridvan Bode

Titulli: Ministër i Financave

Ujësjiellës-Kanalizime, Korçë (UKKO)

Nga:

Emri: Petrit Tare

Titulli: Drejtor i UKKO-së

Drafti përfundimtar i datës 19 dhjetor 2011

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

Sheshi "Skënderbej", nr. 5,

Tiranë, Shqipëri

Heike Schwarzl

Ref. ynë: hsz

Tel: +49697431 4225

E-mail: heike.schwarzl@kfw.de

Data:



Ndërmarrja e Ujësjetllës-Kanalizimeve, Korçë, UKKO

Rr. "Unaza e Qytetit", rajoni nr. 2

Korçë, Shqipëri

LE a4 Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Republikën e Shqipërisë

Kanalizime Korçë IV, fondet IPA

Euro 4, 018, 000 milionë (kontribut financiar)

BMZ - nr.: 2020 60 408

Këtu: Amendimi i marrëveshjes së veçantë të marrëveshjes së kredisë dhe të projektit të datës 8.10.2008

Të dashur zotërinj,

Në plotësim të marrëveshjes së veçantë të marrëveshjes së kredisë dhe të projektit të datës 8.10.2008 dhe në përputhje me marrëveshjen e financimit të projektit ("Korça IV", fondet IPA) të nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (Marrësi) dhe Ujësjetllës-Kanalizime, Korçë (UKKO) (agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW-së, të datës _____, sa më poshtë do të përcaktohet me një amendament të marrëveshjes së veçantë të lartpërmendur e cila mbetet në fuqi e paprekur prej tij:

Sipas nenit 1.2 të marrëveshjes së financimit dhe të projektit ("Korça IV", fondet IPA):

Detajet e projektit, si dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga kontributi financiar;

Sipas nenit 3.1 të marrëveshjes së financimit dhe të projektit ("Korça IV", fondet IPA):

Procedura e disbursimit, në veçanti prova që tregon se shumtat e kontributit financiar të disbursuara janë përdorur për qëllimin e parashikuar;

Sipas nenit 7.2 të marrëveshjes së financimit të projektit ("Korça IV", fondet IPA):

Detajet që i përkasin nenit 7.1 të marrëveshjes së financimit dhe të projektit.

Ne propozojmë që amendamentet e mëposhtme të paragrafëve të përmendur më poshtë, specifike për "Korça IV", fondet IPA, të pranohen. Të gjitha dispozitat dhe anekset e marrëveshjes së veçantë të përmendur më sipër të marrëveshjes së kredisë dhe të projektit të datës 8.10.2008 aplikohen edhe për marrëveshjen e financimit dhe të projektit për "Korça IV", fondet IPA:

I. Hartimi i projektit

1. Detajet e projektit

Shtohet

Fondet IPA 2010 do të përdoren për të financuar masat shtesë të investimit të rëna dakord me procesverbalin e mbledhjes "Shtesë në projektin kanalizimet "Korça IV"", datë 22.11.2010:

- Ndërtimi i rrjetit dytësor të kanalizimeve në lagjen franceze (afërsisht 5 km) duke përfshirë rehabilitimin e rrugës;

- Shërbime të konsulentit të implementimit (supervizioni).

Treguesi për përqindjen e lidhjes, siç përmendet në aneksin 1 të marrëveshjes së veçantë, të marrëveshjes së kredisë dhe të projektit të datës 8.10.2008 do të jetë si më poshtë:

- Të paktën 95% e popullsisë lidhet me sistemin e kanalizimit.

Të gjithë treguesit e tjerë mbeten të pandryshuar.

2. Afati kohor

Shtohet:

Masat për punimet e ndërtimit për "Korça IV", masat e financuara nga fondet IPA janë planifikuar të finalizohen në 2012.

3. Kostoja dhe financimi total

Shtohet:

Fondet IPA 2010 në shumën prej 4.018 milionë eurosh janë të disponueshme për projektin e kanalizimeve "Korça IV". Kostot totale të projektit të modifikuar duke përfshirë fondet IPA 2010 shkojnë në 24.268 milionë euro.

II. Implementimi i projektit

2. Caktimi i konsulentëve dhe institucioneve të tjera

Shtohet paragrafi 2.3

2.3 Dokumentet e tenderit do të përfshijnë një deklaratë që pranueshmëria e ofertuesve, midis faktorëve të tjerë, do t'i nënshtrohet verifikimit sipas bazës së të dhënave qendrore të përjashtimit të BE-së.

3. Dhënia e kontratave për mallrat dhe shërbimet e tjera

Sqarim i paragrafit 3.1

3.1 Kontratat për mallrat dhe shërbimet e tjera të financuar nga “Korça IV”, fondet IPA do të jepen nëpërmjet ofertimit konkurrues ndërkombëtar dhe gjithashtu do të aplikohet libri i kuq FIDIC.

Sqarim për paragrafin 3.6

3.6 Kapitulli aplikohet edhe për kontributin financiar të Komisionit Europian.

Shtohet në kapitullin shtesë 6

6. Caktimi i audituesit

6.1 Për përdorimin e kontributit financiar të dhënë nga Bashkimi Europian sipas projektit do të kryhet një audit vjetor. KfW dhe Ministria e Financave do të rishikojnë nëse auditi mund të kryhet nga audituesi i përzgjedhur nga Ministria e Financave.

6.2 Audituesi për përdorimin e kontributit financiar të dhënë nga Bashkimi Europian do të përzgjidhet pas një ofertimi konkurrues ndërkombëtar dhe do të certifikojë çdo vit përdorimin siç duhet të kontributit financiar të dhënë nga Bashkimi Europian deri në përfundimin e projektit.

6.3 Audituesi i kontributit financiar (në përputhje me termat e referencës në aneksin 8) të dhënë nga Bashkimi Europian do të financohet nga kontributi financiar.

III. Lista e mallrave dhe e shërbimeve dhe procedura e disbursimit

1. Lista e mallrave dhe e shërbimeve

Sqarim për paragrafin 1.1

1.1 Kapitulli aplikohet edhe për kontributin financiar të Komisionit Europian.

Sqarim për paragrafin 1.3

1.3 Kapitulli aplikohet edhe për kontributin financiar të Komisionit Europian.

2. Procedura e disbursimit

Shtohet

Disbursimi për “Korça IV”, fondet IPA do të rregullohet me rregullat e parashikuara në aneksin nr. 6 (procedura e disbursimit), e cila është pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje.

Kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi Europian do të përdoret për të financuar kontratat që janë dhënë pas ofertimit konkurrues ndërkombëtar.

IV. Raportimi dhe dispozitat e tjera

2. Dispozitat e tjera

Shtohet në paragrafin 2.2

2.2 “Një projekt zhvillimi i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ndërmarrja e Ujës-jellësit dhe Kanalizimeve (UKKO), bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian dhe Republika Federale e Gjermanisë nëpërmjet KfW-së”.

Një vulë e projektit e dhënë nga Ambasada Gjermane dhe logoja europiane (dymbëdhjetë yje të verdha në një sfond blu) do të vendosen në pllakën që tregon projektin.

Shtohet te kapitulli 2

2.4 Të gjitha automjetet dhe pajisjet e prokuruar nga konsulenti për projektin do t'i transferohen agjencisë së zbatimit të projektit pas përfundimit të projektit. Prova dokumentare e transferimit do të mbahet nga agjencia e zbatimit të projektit deri në pesë vjet pas përfundimit të projektit.

2.5 Agjencia e zbatimit të projektit do të sigurojë që të gjitha publikimet që lidhen me projektin dhe dokumentet e prodhuara nga konsulenti të përfshijnë një referencë për faktin se projekti është i bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian dhe të tregojë logon europiane (dymbëdhjetë yjet e verdha me një sfond blu). E njëjta gjë aplikohet edhe për automjetet dhe pajisjet të cilat janë të prokuruar nga



konsulentit për projektin deri sa ato t'i transferohen agjencisë së zbatimit të projektit pas përfundimit të projektit.

2.6 Agjencia e zbatimit të projektit do të publikojë detajet e mëposhtme të të gjitha kontratave që janë financuar sipas kësaj marrëveshjeje në faqen e internetit: titullin dhe llojin e kontratës, adresën dhe kombësinë e kontraktuesit, shumën e kontratës.

2.7 Agjencia e zbatimit të projektit do të sigurojë që i gjithë dokumentacioni që i përket përgatitjes dhe implementimit të projektit të jetë i disponueshëm për auditim të paktën deri në 6 vjet pas disbursimit të fundit sipas projektit. Agjencia e zbatimit të projektit gjithashtu do të sigurojë që Komisioni Europian ose përfaqësuesit e tij të jenë në gjendje që të kryejnë vlerësimet e projektit përpara, gjatë ose pas implementimit të tij.

2.8 Dispozitat e mësipërme mund të amendohen ose të modifikohen në çdo kohë me pëlqim reciprok, në qoftë se kjo do të ishte e dobishme për implementimin e projektit ose për zbatimin e marrëveshjes së financimit dhe të projektit. Në të gjitha drejtimet e tjera, dispozitat e neneve 6.2, 6.3 dhe 8 të marrëveshjes së financimit dhe të projektit do të aplikohen në këtë amendament të marrëveshjes së veçantë të marrëveshjes së kredisë dhe të projektit të datës 8.10.2008 dhe në marrëveshjen e financimit dhe të projektit për kontributin financiar të dhënë nga Bashkimi Europian (fondet IPA) të datës _____ përkatësisht.

Ju lutemi, konfirmoni pëlqimin tuaj për marrëveshjen e mësipërme duke nënshkruar në formë ligjore detyruese dhe duke i kthyer kopjet të bashkëlidhura.

I juaji sinqerisht,

KfW

Nga:

Emri:

Titulli:

Lexuar dhe rënë dakord:

Tiranë

Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (marrësi)

Nga:

Emri: Ridvan Bode

Titulli: Ministër i Financave

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

Nga:

Emri: Sokol Olldashi

Titulli: Ministër i Punëve Publike dhe Transportit

Ujësjiellës-Kanalizime, Korçë (UKKO)

Nga:

Emri: Petrit Tare

Titulli: Drejtor i UKKO-së

Anekset

Amendimi i anekseve të marrëveshjes së veçantë të marrëveshjes së kredisë dhe të projektit të datës 8.10.2008:

Amendohet aneksi 1

Treguesi për përqindjen e lidhjes do të rritet:

- Të paktën 95% e popullatës lidhet me sistemin e kanalizimeve.

Treguesit e tjerë mbeten të pandryshuar

Amendohet aneksi 2

Masat për punimet e ndërtimit për "Korça IV", masat e financuara nga fondet IPA planifikohen të finalizohen në 2012-ën.

Amendohet aneksi 3

Fondet IPA 2010 në shumën prej 4,018 milionë eurosh janë të disponueshme për projektin e kanalizimit “Korça IV”. Kostot totale të projektit të modifikuar që përfshijnë fondet IPA 2010 shkojnë në 24.268 milionë euro.

Sqarime për aneksin 6

Aneksi 6 (procedura e disbursimit) i marrëveshjes së veçantë të marrëveshjes së kredisë dhe projektit të datës 8.10.2010 do të aplikohet për “Korça IV”, fondet IPA.

Shtohet aneksi 8

Termet e referencës për audituesit e kontributit financiar të BE-së.

Lexuar dhe rënë dakord:

Tiranë, _____

“Korça IV”, fondet IPA

Termet e referencës për audituesit e kontributit financiar të BE-së

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Republikën e Shqipërisë

Marrëveshja e financimit dhe e projektit

(Kontributi financiar) i dhënë nga Bashkimi Europian

“Korça IV”, fondet IPA

4.018.000 euro – Kontribut financiar

KfW - nr. reference: 2020 60 408

1. HYRJE

Marrëveshja e kontributit të Bashkimit Europian (marrëveshja nr. IPA/2011/267-755) midis Bashkimit Europian dhe KfW-së parashikon financimin e përbashkët të projektit “Korça IV” dhe administrimin e kontributit të BE-së nga KfW në përputhje me procedurat e bashkëpunimit financiar gjerman (Udhëzimet për caktimin e konsulentëve në projektin e bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim) dhe “Udhëzimet për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punimeve sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim”).

Bashkimi Europian i jep 4,018,000 euro si grand (duke përjashtuar pagesat e drejtuesve të KfW-së) Republikës së Shqipërisë (marrësi). KfW-ja i jep marrësit/huamarrësit një kredi prej 15 milionësh, i cili i kanalizon fondet për Ujësjetellës-Kanalizime, Korçë (UKKO) (agjencia e zbatimit të projektit).

Sipas marrëveshjes së kontributit, grandit i BE-së dhe kredia e KfW-së do të administrohen nëpërmjet dy llogarive të ndryshme, ndërsa KfW-ja duhet të hapë një llogari të veçantë që mban interes për fondet e BE-së “Llogaria speciale për ndërtimin e ujësjetellësve dhe sistemeve të kanalizimit në bashkitë e përzgjedhura”. Kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi Europian, si dhe interesi i fituar mbi llogarinë speciale do të përdoren vetëm për të financuar kontratat sipas projektit që është dhënë pas ofertimit konkurrues ndërkombëtar. Pagesat sipas këtyre kontratave, do të disbursohen proporcionalisht nga kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi Europian dhe kredia e dhënë nga bashkëpunimi financiar gjerman për këto kontrata.

KfW e disburson kredinë dhe fondet e BE-së me kërkesë të agjencisë së zbatimit të projektit në përputhje me progresin e projektit të financuar nëpërmjet procedurës së disbursimit të drejtpërdrejtë (për shërbimet e konsulencës) dhe disbursimit të drejtpërdrejtë (për mallrat dhe shërbimet), siç është rënë dakord me marrëveshjen e veçantë të marrëveshjes së kredisë dhe projektit, në amendimin e marrëveshjes së veçantë dhe në marrëveshjen e financimit dhe projektit midis KfW-së, marrësit/huamarrësit dhe agjencisë së zbatimit të projektit.

KfW mbikëqyr përdorimin kontraktual të fondeve që i ka rezervuar për mallra dhe shërbime specifike mbi bazën e marrëveshjes së veçantë dhe të amendimit të marrëveshjes së veçantë. Lista e mallrave dhe e shërbimeve, si dhe fondet korresponduese të rezervuara përbëjnë kështu kuadrin brenda të cilit agjencia e zbatimit të projektit mund të kërkojë disbursim nga KfW, kur të jenë plotësuar të gjitha parakushtet kontraktuale për disbursim.

2. Objektivi i përgjithshëm i auditit

Objektivi i përditshëm i auditit është certifikimi nëse fondet e BE-së sipas projektit të



lartpërmendur janë përdorur në përputhje me marrëveshjen e financimit dhe të projektit, marrëveshjen e veçantë dhe amendimin e marrëveshjes së veçantë midis Republikës së Shqipërisë (marrësi), Ujësjetllës-Kanalizime, Korçë (UKKO) (agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW-së. Opinioni i audituesit i parashtruar në raportin e opinionit të auditit, në mënyrë të qartë do të deklarojë:

1. Nëse është siguruar nga projekti përdorimi siç duhet i fondeve për qëllimin e përcaktuar;
2. Nëse shpenzimet janë mbështetur me prova përkatëse dhe të besueshme. Nëse janë vënë në dispozicion të gjitha dokumentet dhe të dhënat mbështetëse në lidhje me deklaratat e shpenzimeve të paraqitura si bazë për kërkesat e tërheqjeve;

3. Nëse janë identifikuar mangësi specifike dhe fusha të dobësisë në sistemet dhe kontrollet e brendshme të agjencisë së zbatimit të projektit. Aty ku identifikohen mangësi, këto duhet të shënohen në mënyrë të veçantë.

3. Objekti i shërbimeve

Çdo vit derisa fondet të jenë disbursuar totalisht audituesi do të shqyrtojë:

- Kontabilitetin gjithëpërfshirës me anë të dokumenteve korresponduese;
- Përputhjen e procedurave të tenderimit dhe disbursimit siç është rënë dakord në marrëveshjen e veçantë të marrëveshjes së kredisë dhe të projektit, amendimit të marrëveshjes së veçantë dhe të marrëveshjes së financimit dhe të projektit;

- Disbursimet e duhura sipas listës së mallrave dhe shërbimeve siç është rënë dakord në marrëveshjen e veçantë të sipërpërmendur dhe amendamentin e marrëveshjes së veçantë;

- Përdorimin e fondeve nëpërmjet inspektimeve në vend në Shqipëri mbi bazën e një modeli gjithëpërfshirës.

Subjekte të auditit në zyrën e agjencisë së zbatimit të projektit në Tiranë, gjatë inspektimit në vend janë dokumentet e tenderit, kontratat e mallrave dhe të shërbimeve, dokumentet korresponduese të lëvrimit, dokumentet e ndërtimit etj., në mënyrë që të vlerësohet përdorimi i duhur fizik i fondeve.

Auditi do të kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare për auditin siç janë publikuar nga bordi i auditit ndërkombëtar dhe standardeve të sigurimit të federatës ndërkombëtare të kontabilistëve, duke ju referuar në mënyrë të veçantë ISA 800 (raporti i audituesit për angazhime auditimi me qëllim të veçantë) dhe do të përfshijë ato teste dhe kontrolle që audituesi i konsideron të nevojshme, si dhe vizita në vend në qoftë se edhe këto konsiderohen të nevojshme. Audituesi duhet të ketë parasysh që për krijimin e opinionit të auditit, ai duhet të kryejë një audit përputhshmërie dhe jo një audit normal ligjor.

4. Personeli

Meqenëse objekti i shërbimeve është shumë i kufizuar, një auditues do të jetë i mjaftueshëm për të kryer auditin. Shërbimi do të kryhet nga një kontabilist i licencuar.

5. Koha e shërbimeve

Koha e nevojshme për auditin vlerësohet të jetë 6 ditë në vit, duke përfshirë kohën e udhëtimit në Shqipëri dhe raportimin. Auditi i parë do të kryhet pasi të jenë disbursuar 2 milionë euro dhe më pas çdo vit.

6. Raportimi

Audituesi do të japë një raport të shkurtër, në të cilin ai përshkruan procedurat e tij të auditimit, modelet e përdorura dhe rezultatet e auditimit. Gjuha që do të përdoret është anglishtja. Numri i origjinaleve 2, numri i kopjeve: 5 printime dhe 1 dosje elektronike (pdf e versionit të nënshkruar). Projektraporti do të dërgohet brenda 4 javësh pas auditit dhe versioni përfundimtar 4 javë pasi të jetë komentuar nga agjencia e zbatimit të projektit (Ujësjetllës-Kanalizime, Korçë (UKKO)). Një version origjinal do t'i dorëzohet KfW-së, LIIIa4, Postfach 11 11 41, 60046 Frankfurt mbi Main, Republika Federale e Gjermanisë.

VENDIM
Nr. 253, datë 12.4.2012

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit, sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në fund të shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, shtohen personat e renditur në listën “a”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me Al-Qaida-n, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talebanët dhe Al-Qaida-n.

2. Në fund të shkronjës “D”, “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, shtohen kompanitë e renditura në listën “b”, “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si kompani që i takojnë ose bashkëpunojnë me Al-Qaida-n, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talebanët dhe Al-Qaida-n.

3. Nga lista e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen personat e renditur në listën “c”, “Lista e të çregjistruarve nga “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida””, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë ose bashkëpunëtorë me Al-Qaida-n me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

4. Nga lista e shkronjës “D”, “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen kompanitë e renditura në listën “ç”, “Lista e të çregjistruarve nga “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida””, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si kompani të çregjistruara nga lista që i takojnë ose bashkëpunojnë me Al-Qaida-n me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

a) Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida:

1. MOCHMMAD: ACHWAN;
2. ABDUL: ROSYID; RIDHO: BA’ ASYIR;
3. MUSTAFA: HAJJI: MUHAMMAD: KHAN;
4. ABDUR: REHMAN;
5. MONIR: CHOUKA;
6. YASSIN: CHOUKA;
7. MEVLUT: KAR;
8. HAFIZ: ABDUL SALAM: BHUTTAVI;
9. ZAFAR: IQBAL;
10. FAZAL: RAHIM.



b) Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida:

1. JEMMAH ANSHORUT TAUHID (JAT).

c) Lista e të çregjistruarve nga “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida:

1. ABU SUFIAN; AL-SALAMBI; MUHAMMAED AHMED; ABD AL-RAZZIQ;

2. ANWAR; NASSER; ABDULLA; AL-AULAQI;

3. ALI; AHMED NUR; JIM’ALE;

4. SAJID; MOHAMMED; BADAT.

ç) Lista e të çregjistruarve nga “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida:

1. BARAKAAT NORTH AMERICA, INC.;

2. BARAKAT COMPUTER CONSULTING (BCC);

3. BARAKAT CONSULTING GROUP (BCG);

4. BARAKAT GLOBAL TELEPHONE COMPANY;

5. BARAKAT POST EXPRESS (BPE)

6. BARAKAT REFRESHMENT COMPANY.

VENDIM

Nr. 256, datë 12.4.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 652, DATË 14.9.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE
“MASTER I SHKENCAVE”/“MASTER I ARTEVE TË BUKURA”, PËR VITIN AKADEMIK
2011- 2012”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, dhe të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tabelën nr. 1/1, bashkëlidhur vendimit nr. 652, datë 14.9.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

a) Tarifa për kredit 2011-2012 (në lekë), e përcaktuar në kolonën “F”, të tabelës për programet e studimeve të Universitetit të Arteve, nga “1 476” të bëhet “1000”;

b) Tarifa totale për 120 kredite (në lekë), e përcaktuar në kolonën “G”, të tabelës për programet e studimeve të Universitetit të Arteve, nga “170 000” të bëhet “120 000”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 257, datë 12.4.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT, TË Z. MEHMET XHEKA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë në buxhetin e miratuar për vitin 2012, zëri “mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit, të z.Mehmet Xheka.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2012.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 258, datë 12.4.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. KLODIAN SEFERAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, zëri “mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Klodian Seferaj.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2012.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 259, datë 12.4.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z.REZAR VESELI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në zërin “mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 750 000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Rezar Veseli.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2012.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 260, datë 12.4.2012

PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDEVE TË DHËNA SIPAS MARRËVESHJES SË KREDISË, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS (CEB), PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT TË REFORMËS SË QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”, TIRANË, FAZA I

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 9412, datë 20.5.2005 “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEB), për financimin e fazës së parë të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rishpërndarjes së fondeve të dhëna sipas marrëveshjes së kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, për financimin e programit të reformës së Qendrës Spitalore Universitare, “Nënë Tereza”, Tiranë, faza I, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RIALOKIMI

Kategoritë	Shuma e rialokuar e shpërndarë sipas kategorive (shprehur në USD)
Punime civile	12,706,259.85
Pajisje	550,000
Mbikëqyrja e punimeve	970,000
Auditimi/kontrolli	150,000
Shpenzime administrative (PIU)	116,700

VENDIM

Nr. 262, datë 13.3.2012

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 933, DATË 17.11.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV
TË KËRKESAVE DHE MASËS SË DËMSPËRBLIMIT FINANCIAR PËR FAMILJARËT E
VIKTIMAVE TË EKZEKUTUARA PADREJTËSISHT, PA GJYQ, PËR MOTIVE POLITIKE,
GJATË PERIUdhËS 30.11.1944 DERI MË 1.10.1991”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të tretë të nenit 2 të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmspërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun I të vendimit nr. 933, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:
 - a) Pas shkronjës “c” të pikës 6 të shkronjës “A”, “Fillimi i shqyrtimit të kërkesave”, shtohet shkronja c/1, me këtë përmbajtje:

“c/1) aktin administrativ të lëshuar nga komisioni trepalësh dhe/ose dekoratë nderi të dhënë nga Presidenti i Republikës pas datës 1.10.1991, për viktimën e ekzekutuar padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike.”.
 - b) Në pikën 6 të shkronjës “B”, ‘Shqyrtimi i kërkesës’, pas fjalëve “... nuk disponohen të dhëna për kërkuesin ...” shtohen fjalët “..., si dhe kur nuk ka të dhëna të paraqitura nga aplikanti ...”.
2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

VENDIM

Nr. 263, datë 12.4.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR BASHKËPUNIMIN
NDËRMJET MEKANIZMAVE INSTITUCIONALË DHE ORGANIZATAVE
JOFITIMPRURËSE, PËR REALIZMIN E POLITIKAVE VENDORE PËR MBROJTJEN E TË
DREJTAVE TË FËMIJËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 10347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mekanizmat në nivel qendror dhe vendor bashkëpunojnë ngushtësisht me organizatat jofitimprurëse që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre të drejtat e fëmijëve.



2. Bashkëpunimi ka në themel parimet e përgjithshme të interesit më të lartë të fëmijës, barazisë dhe mosdiskriminimit për shkaqet që janë të përcaktuara në ligj.

3. Mekanizmat institucionalë në nivel qendror dhe vendor bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse, me qëllim realizimin e politikave vendore në:

a) hartimin dhe zbatimin e ligjeve, strategjive kombëtare dhe programeve direkte që kanë në fokus fëmijët dhe nevojat e tyre;

b) zbatimin e strategjive sektoriale e ndërsektoriale dhe programeve të tjera, të cilat nëpërmjet drejtimeve të tyre ndikojnë në jetesën e fëmijëve;

c) ngritjen dhe fuqizimin e njësisve për mbrojtjen e fëmijëve/njësive për të drejtat e fëmijëve dhe të strukturave të ngarkuara me çështje sociale, që funksionojnë brenda strukturave administrative të njësive të qeverisjes vendore;

ç) kontributin e përbashkët në grupet multidisiplinore për mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve të fëmijëve në rrezik;

d) identifikimin e problematikave, pengesave dhe nevojave lidhur me shërbimet (sociale, shëndetësore, arsimore, psikologjike e ligjore) në nivel vendor;

dh) kryerjen e trajnimeve dhe programeve të përbashkëta për kualifikimin e personave përgjegjës për çështjet e fëmijëve, në strukturat e pushtetit vendor;

e) kryerjen e analizave, studimeve dhe vrojtimeve të kryera në nivel qendror dhe vendor për aspekte të ndryshme të jetës së fëmijëve dhe kategorive të tyre;

ë) bashkëpunimin në fushën e mbledhjes së të dhënave statistikore, analizës dhe shkëmbimit të informacionit;

f) organizimin e fushatave të përbashkëta të sensibilizimit për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;

g) hartimin dhe zbatimin e projekteve që synojnë përmirësimin e gjendjes së të drejtave të fëmijëve në komunën/bashkinë/qarkun ku ushtron veprimtarinë e saj organizata jofitimprurëse.

4. Mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në nivel qendror e vendor, në kuadër të këtij bashkëpunimi, angazhohen:

a) të lehtësojnë procesin e bashkëpunimit të organizatave jofitimprurëse me institucionet shtetërore në nivel vendor;

b) të koordinojnë iniciativat e ndërmarra nga OJF-të me iniciativa të tjera, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët ose programeve të tjera;

c) të marrin pjesë në takime të rregullta konsultative, trajnime, konferenca dhe aktivitete të tjera të planifikuara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;

ç) të mbështesin, nëpërmjet orientimit të donatorëve vendas dhe ndërkombëtarë, zbatimin në nivel vendor të objektivave të Strategjisë Kombëtare të Fëmijëve;

d) të ndërjegjësojnë komunitetin, në bashkëpunim me njësitë për mbrojtjen e fëmijëve /njësitë për të drejtat e fëmijëve, strukturat e ngarkuara me çështje sociale në nivel komune/bashkie/qarku dhe autoritete të tjera, duke organizuar takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/komunës/qarkut;

dh) të mbështesin rastet konkrete të fëmijëve në rrezik, të paraqitura nga organizatat jofitimprurëse, pas identifikimit të nevojave për shërbime konkrete ligjore, psiko-sociale, akomodim pranë institucioneve rezidenciale, strehëzave për viktimat e dhunës në familje, qendrave ditore, në varësi të rastit, etj.

5. Organizatat jofitimprurëse, sipas legjislacionit në fuqi, angazhohen:

a) të mbështesin njësitë për mbrojtjen e fëmijëve/njësitë për të drejtat e fëmijëve dhe strukturat e ngarkuara me çështje sociale, në nivel komune/bashkie/qarku, në iniciativat e përbashkëta për zbatimin e programeve e projekteve konkrete, të ndërmarra në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve e veçanërisht për mbështetjen e grupeve në rrezik të përjashtimit social, si: fëmijët nga familjet e varfra; fëmijët që punojnë në rrugë; fëmijët e trafikuar me qëllime shfrytëzimi brenda dhe jashtë vendit (përfshirë shfrytëzimin seksual); fëmijët me aftësi të kufizuara; fëmijët që vuajnë nga dhuna në familje etj.;

b) të ndajnë me institucionet shtetërore në nivel vendor praktikat më të mira në drejtim të krijimit të mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve;

c) të marrin pjesë aktivisht në diskutimet dhe konsultimet për standardet, politikat, legjislacionin që lidhet me mbrojtjen e fëmijëve në shërbimet sociale, shëndetësore, ligjore, arsim dhe shërbime të tjera;

ç) të kontribuojnë në vlerësimet për nevojat sociale të komuniteteve rurale, periurbane e urbane, duke përfshirë ekspertë dhe duke lehtësuar procesin e vlerësimit përmes vrojtimeve, grupeve të fokusuara apo intervistave;

d) të ndihmojnë në ngritjen e shërbimeve komunitare alternative për grupet në nevojë, si dhe në angazhimin e komuniteteve në procesin e vlerësimit të nevojave, planifikimit dhe zbatimit;

dh) të marrin pjesë aktivisht në grupet multidisiplinore të ngritura në kuadër të mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik;

e) të ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve në nivel qendror dhe vendor;

ë) të informojnë në mënyrë periodike Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës me të dhëna apo me çdo lloj informacioni tjetër për gjendjen e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe kontributin e tyre në këtë të fundit;

f) të hartojnë kode të sjelljes dhe rregullore për procedurat për mbrojtjen e fëmijëve, me qëllim ushtrimin me efektivitet të veprimitarisë së tyre.

6. Institucionet qendrore dhe vendore në nivel lokal hartojnë dhe zbatojnë marrëveshje bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse në fushën e:

a) ofrimit dhe forcimit të shërbimeve ekzistuese (sociale, shëndetësore, arsimore, juridike);

b) planifikimit dhe ofrimit të shërbimeve të reja;

c) mbështetjes për ngritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të njësive për mbrojtjen e fëmijëve dhe njësive për të drejtat e fëmijëve, në nivel komune/bashkie/qarku;

ç) hartimit dhe zbatimit të projekteve, studimeve dhe protokollove të përbashkëta;

d) ofrimit të trajnimeve të përbashkëta për çështje që lidhen me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

7. Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 264, datë 12.4.2012

**PËR PROCEDURAT E KRYERJES SË KONTROLLIT DHE TË VENDOSJES SË SANKSIONIT
NGA AGJENCIA SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 37 të ligjit nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (ASHMDF) fillon procedurën e kryerjes së kontrollit, kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së:

a) fëmijës së interesuar ose të dëmtuar;

b) prindit, kujdestarit ligjor apo përfaqësuesit ligjor të fëmijës;

c) një organizate jofitimprurëse që paraqet një prokurë të posaçme për të përfaqësuar interesat e fëmijës;

ç) çdo personi tjetër ligjërisht përgjegjës për fëmijën;

d) çdo personi fizik që vihet në dijeni lidhur me shkeljen e një të drejte të fëmijës.



2. ASHMDF-ja fillon procedurën e kryerjes së kontrollit edhe me nismën e vet, kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, për raste të veçanta të bëra publike, por, në çdo rast, me pëlqimin e fëmijës, prindit, kujdestarit ose përfaqësuesit ligjor të fëmijës.

3. Në rastet kur ASHMDF-ja fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet ose të subjekteve të përcaktuara në shkronjën “d” të pikës 1 të këtij vendimi, dhe kur prindi/kujdestari ligjor/përfaqësuesi ligjor ose personi tjetër ligjërisht përgjegjës për fëmijën nuk vepron, ASHMDF-ja, pasi vlerëson moshën dhe shkallën e pjekurisë së fëmijës së dëmtuar, kërkon pëlqimin e tij.

4. Subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, së bashku me kërkesën paraqesin edhe provat e disponueshme para ASHMDF-së, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, me kusht që të mbahet procesverbal.

5. Ankesa përmban, të paktën:

a) emrin dhe mbiemrin e ankuesit;

b) shpjegimin se si mund të kontaktohet ankuesi, prindi/kujdestari ligjor/përfaqësuesi ligjor ose personi tjetër ligjërisht përgjegjës i fëmijës së dëmtuar;

c) të dhëna për subjektin që pretendohet të ketë kryer shkeljen e së drejtës ose, nëse nuk ka të tilla, shpjegim për pamundësinë e identifikimit të tij;

ç) shpjegimin e shkeljes së pretenduar;

d) masat që kërkohen nga ASHMDF-ja;

dh) datën, nënshkrimin dhe vendin e ankuesit ose të përfaqësuesit të tij.

6. Ankesa nuk pranohet nga ASHMDF-ja nëse:

a) është anonime;

b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para ASHMDF-së ose është e papajtueshme me përcaktimet e ligjit nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” dhe të këtij vendimi;

c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja;

ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;

d) të gjitha faktet, që përbëjnë thelbin e ankesës, kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”;

dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e shkeljes ose më vonë se një vit nga marrja dijani nga fëmija i dëmtuar/prindi/kujdestari i tij ligjor për këtë fakt.

7. Subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa, njoftohet me shkrim nga ASHMDF-ja brenda 8 (tetë) ditëve nga data e marrjes së ankesës.

8. ASHMDF-ja nuk i ngarkon ankuesit më ndonjë tarifë për shqyrtimin e ankesës.

9. Me marrjen e ankesës, ASHMDF-ja verifikon faktet. Për këtë qëllim, ASHMDF-ja mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit, kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda (dhjetë) 10 ditëve nga data që palët marrin njoftimin.

10. Për shqyrtimin e ankesës ASHMDF-ja:

a) kryen hetime në vend, përfshirë edhe hyrjen në çdo zyrë të administratës publike, qendrore dhe vendore, të personave fizikë ose juridikë privatë, si dhe këqyrjen e akteve dhe/ose të dokumenteve që ato kanë në lidhje me çështjen në hetim, duke respektuar kërkesat procedurale sipas legjislacionit në fuqi;

b) kërkon informacione dhe shpjegime nga çdo organ i administratës publike, qendrore dhe vendore, të personave fizikë ose juridikë privatë, si dhe të marrë çdo dosje apo material, që ka lidhje me hetimin, duke vendosur edhe afate për dërgimin e këtyre informacioneve;

c) merr në pyetje çdo person, që, sipas saj, është i lidhur me çështjen në hetim dhe thërret të gjithë personat pa imunitet;

ç) kërkon ekspertizat përkatëse nga ekspertë të palëve të treta;

d) kur e çmon të nevojshme, merr informacion edhe nga çdo person ose burim tjetër.

11. ASHMDF-ja, sipas rastit:

a) zhvillon një seancë dëgjimore dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar;

b) ndërmjetëson marrëveshje pajtimi ndërmjet ankuesit dhe personit, kundër të cilit është paraqitur ankesa, duke u bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

12. ASHMDF-ja pasqyron në një relacion përmbledhës veprimet që kryen lidhur me çështjen sipas pikave 7, 8, 9, 10 e 11 të këtij vendimi, veprime të cilat i dokumenton në dosjen që do të arkivojë për këtë çështje.

13. ASHMDF-ja përfundon procedurat e parashikuara në pikën 10 brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së ankesës ose, nëse është zhvilluar një seancë dëgjimore publike, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së ankesës. ASHMDF-ja shprehet me vendim të kryetarit, për të cilin njoftohen palët brenda 8 (tetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit.

14. Në marrjen e vendimit sipas pikës 13 vlerësohen:

- a) efektshmëria e tij dhe roli parandalues;
- b) rrethanat e kryerjes së shkeljes;
- c) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë;
- ç) rëndësia e kundërvajtjes;
- d) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.

15. Vendimi i kryetarit të ASHMDF-së mund të merret:

a) për të urdhëruar organin e administratës publike/personin në funksione publike, personin, fizik ose juridik, kundër të cilit është paraqitur ankesa, për marrjen e masave ose kryerjen e rregullimeve të duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente sipas afateve të parashikuara në nenin 137 e në vijim të Kodit të Procedurave Administrative;

b) për të vendosur gjobë ndaj organit të administratës publike/personit në funksione publike, personit fizik ose juridik. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.

16. Nëse vendoset gjobë, në vendimin e kryetarit të ASHMDF-së përcaktohet shuma e gjobës, duke marrë parasysh:

- a) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën;
- b) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht të gjitha burimet e të ardhurave dhe, nëse shkelja kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit e fitimi, si dhe pagat totale të paguara punonjësve;
- c) nëse e njëjta shkelje ka ndodhur mbi disa fëmijë. Në këtë rast vendoset vetëm një gjobë, por në përputhje me kërkesat e pikës 14 të këtij vendimi.

17. Në vendimin e kryetarit të ASHMDF-së përcaktohen:

- a) identiteti i kundërvajtësit;
- b) shpjegimi i përmbledhur i fakteve dhe i provave, ku mbështetet vendimi;
- c) shkelja e kryer, duke përcaktuar dispozitën ligjore ku mbështetet vendimi;
- ç) urdhërimi për rregullimet apo masat që duhet të ndërmerren ose për vendosjen e gjobës;
- d) cilësimi si titull ekzekutiv për masën e gjobës;
- dh) e drejta për ankim dhe afati;
- e) organi i cili ka nxjerrë aktin.

18. Vendimi i kryetarit të ASHMDF-së hartohet në tri kopje, nga të cilat një kopje i dërgohet organit të administratës publike/personit në funksione publike, personit, fizik ose juridik, i cili është vlerësuar se ka kryer kundërvajtjen administrative, një kopje i dërgohet ASHMDF-së dhe një kopje ministrit që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

19. Nëse ASHMDF-ja urdhëron kryerjen e rregullimeve ose marrjen e masave, organi i administratës publike/personi në funksione publike, personi, fizik ose juridik, kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 (tridhjetë) ditëve para ASHMDF-së për veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit.

20. Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa, nuk e informon ASHMDF-në brenda afatit të përcaktuar në pikën 19 të këtij vendimi, ose nuk e zbaton vendimin, kryetari i ASHMDF-së vendos masë për ndëshkimin me gjobë për subjektin, kundër të cilit është paraqitur ankesa.



21. Në rastet kur konstatohet se shkelja e të drejtave të parashikuara në nenin 40 të ligjit nr. 10 347, datë 4.11.2010 nuk përbën kundërvajtje administrative, por mund të përbëjë vepër penale, ASHMDF-ja ka detyrimin të vërë në lëvizje prokurorinë pranë gjykatës kompetente për të shqyrtuar çështjen.

22. Ngarkohet Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 265, datë 12.4.2012

**PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E MEKANIZMIT TË BASHKËRENDIMIT TË PUNËS
NDËRMJET AUTORITETEVE SHTETËRORE, PËRGJEGJËSE PËR REFERIMIN E RASTEVE
TË FËMIJËVE NË RREZIK, SI DHE MËNYRËN E PROCEDIMIT TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 35 të ligjit nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Mekanizmi i bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik

1. Mekanizmi i bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik përbëhet nga:

a) Komiteti drejtues për bashkërendimin e punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse, në nivel vendor, për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik;

b) Grupi teknik multidisiplinar;

c) Njësia për të drejtat e fëmijës, në nivel qarku;

ç) Njësia për mbrojtjen e fëmijës, në nivel bashkie/komune.

2. Komiteti drejtues për bashkërendimin e punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse, në nivel vendor, për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, funksionon pranë çdo këshilli të qarkut.

3. Komiteti drejtues kryesohet nga kryetari i këshillit të qarkut dhe në përbërje të tij ka këta anëtarë:

a) Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Policisë;

b) Drejtuesin e tryezës teknike të komiteteve rajonale antitrafik;

c) Drejtorin e Drejtorisë Arsimore Rajonale;

ç) Drejtorin e Drejtorisë së Rrethit të Shëndetit Publik;

d) Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;

dh) Kryetarë të bashkive/komunave të qarkut;

e) Drejtorin e strukturës për shërbimet sociale pranë bashkisë/komunës;

ë) Drejtorin e njësisë për të drejtat e fëmijës në qark;

f) Punonjësin për të drejtat e fëmijës në qark;

g) Punonjësin për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë;

gj) Drejtorin e Zyrës Rajonale të Punësimit;

h) Përfaqësuesin e shërbimit të provës;

i) Përfaqësuesin e organizatave jofitimprurëse, që në veprimtarinë e tyre merren me çështje të të drejtave të fëmijëve;

j) Ofrues publikë e privatë të shërbimeve sociale.

4. Në takimet e komitetit drejtues ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të organeve të drejtësisë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin ku e shtrin juridiksionin e tij këshilli i qarkut.

5. Komiteti drejtues ka këto detyra:

a) Miraton marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shtetërore apo personave juridikë, privatë, për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të ligjit nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”;

b) Mbështet menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, të referuar nga njësia për mbrojtjen e fëmijës, në bashki/komunë, kur nevojat e rastit nuk adresohen plotësisht nga shërbimet ekzistuese në bashkinë/komunën përkatëse, ose të fëmijëve në rrezik, të referuar nga bashkia/komuna që ende nuk ka ngritur njësinë e mbrojtjes së fëmijës. Në mbledhjen e komitetit drejtues thirren të marrin pjesë anëtarët e nevojshëm për menaxhimin e rastit të fëmijës në rrezik.

Në këto rrethana, komiteti drejtues vepron si një komitet koordinues “ad hoc”, i cili mbledhet çdo herë, sipas rastit që trajtohet;

c) Mbledhet e diskuton problematikën e mbrojtjes së fëmijëve në rrezik çdo 6 (gjashtë) muaj;

ç) Harton çdo 6 (gjashtë) muaj një raport për aktivitetin e tij, për të dhënat për rastet e trajtuara të fëmijëve dhe problematikën e mbrojtjes së fëmijëve në rrezik, në territorin ku ai shtrin juridiksionin dhe një kopje të këtij raporti ia dërgon Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës;

d) Paraqet propozime dhe strategji konkrete për mbështetjen e zhvillimin e shërbimeve dhe të politikave në mbrojtje të fëmijëve, në nivel qarku, të cilat ua përcjell institucioneve shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor.

6. Përfaqësuesit e autoriteteve shtetërore, në nivel vendor u raportojnë çdo 6 (gjashtë) muaj institucioneve qendrore për aktivitetin e tyre në komitetin drejtues. Në këto raportime, anëtarët e komitetit drejtues nuk paraqesin të dhëna konfidenciale dhe kujdesen që të ruhet fshehtësia e të dhënave të fëmijëve.

7. Rregullat dhe procedura e funksionimit të komitetit drejtues përcaktohen në rregulloren e miratuar për këtë qëllim nga këshilli i qarkut.

8. Grupi teknik multidisiplinar është një grup “ad hoc”, i cili funksionon pranë bashkisë/komunës, thirret në bazë të vlerësimit fillestar, drejtohet nga drejtori/përgjegjësi i shërbimeve sociale në bashki/komunë dhe ka në përbërje:

a) Punonjësin për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë;

b) Përfaqësuesin e strukturës së policisë;

c) Përfaqësuesin e Shërbimit Social Rajonal;

ç) Përfaqësuesin e Drejtorisë Arsimore Rajonale;

d) Administratorin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore të bashkisë/komunës ku jeton fëmija;

dh) Prindërit/kujdestarët ligjorë/përfaqësuesit ligjorë të fëmijës ose anëtarët e familjes;

e) Edukatoren e kopshtit ose mësuesin/en e shkollës së fëmijës;

ë) Koordinatorin e psikologëve të DAR-së, psikologun e shkollës;

f) Specialistët e shëndetit, mjekun e familjes apo një specialist që ka vizituar apo vlerësuar fëmijën;

g) Koordinatorin për çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare në bashki/administratorin shoqëror të ngarkuar për çështjet e dhunës në komunë;

gj) Çdo specialist që njih fëmijën ose që mund të flasë për një problem që është shqetësues për fëmijën (avokat, psikolog, punonjës social, specialistë që ofrojnë shërbime të specializuara lidhur me zhvillimin e fëmijës etj.);

h) OJF-të që ofrojnë shërbime për fëmijën, ofruet publikë, privatë të shërbimeve sociale;

i) Fëmijën, bazuar në moshën dhe shkallën e pjekurisë dhe duke marrë në konsideratë mbrojtjen e interesit më të lartë të tij.

9. Në takimet e grupit teknik multidisiplinar ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të organeve të drejtësisë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e qarkut, ku bën pjesë edhe bashkia/komuna, si dhe persona ose institucione, pjesëmarrja e të cilave gjykohet si e domosdoshme për menaxhimin e rastit.

10. Në takimet e grupit teknik multidisiplinar thirren të marrin pjesë anëtarët e nevojshëm për menaxhimin e rastit të fëmijës në rrezik.



11. Grupi teknik multidisiplinar ka për detyrë:

- a) të shqyrtojë dhe të vlerësojë propozimet e njësive për mbrojtjen e fëmijës, bazuar në vlerësimin fillestar të kryer nga kjo njësi;
- b) të analizojë situatën duke diskutuar për mënyrat e ndërhyrjes;
- c) të diskutojë dhe të miratojë planin individual për mbrojtjen e fëmijës, duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijës;
- ç) të sigurojë ofrimin dhe koordinimin e shërbimeve në bazë të planit individual për mbrojtjen e fëmijës;
- d) të mbledhet në mënyrë periodike dhe të rishikojë planin individual për mbrojtjen e fëmijës, duke iu përshtatur nevojave në ndryshim, sipas fëmijës dhe familjes;
- dh) të miratojë mbylljen e rastit kur vlerëson që fëmija nuk është në rrezik.

12. Rregullat e funksionimit të grupit teknik multidisiplinar përcaktohen në rregulloren e miratuar për këtë qëllim nga këshilli i bashkisë/komunës.

13. Njësia për të drejtat e fëmijës, që funksionon brenda strukturës administrative të këshillit të qarkut, ka detyrë:

- a) të koordinojë mbledhjet periodike të komitetit drejtues;
- b) të kërkojë thirrjen e mbledhjes së komitetit drejtues për menaxhimin e rasteve të veçanta të fëmijëve në rrezik, të referuar nga njësia për mbrojtjen e fëmijëve në bashki/komunë;
- c) të monitorojë zbatimin e planit të ndërhyrjes, të miratuar nga komiteti drejtues, në bashkëpunim me njësinë e mbrojtjes së fëmijës në bashki/komunë;
- ç) të propozojë marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shtetërore apo personave juridikë privatë, për ofrimin e shërbimeve për fëmijët në rrezik;
- d) të mbledhë në tryeza diskutimesh të gjithë partnerët e nevojshëm, me qëllim vlerësimin e nevojave, përmirësimin e zbatimit të politikave rajonale për fëmijët në nevojë, forcimin e bashkëpunimit, harmonizimin e aktiviteteve apo ofrimin e shërbimeve për fëmijë;
- dh) të propozojë ndërhyrje strategjike apo ndryshime të politikave rajonale për fëmijët në nevojë, pranë këshillit të qarkut;
- e) të raportojë periodikisht çdo 6 (gjashtë) muaj pranë këshillit të qarkut, komitetit drejtues dhe Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

14. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë funksionon brenda strukturës administrative të bashkisë/komunës dhe ka detyrë:

- a) identifikimin e fëmijëve në rrezik, që janë banorë të përkohshëm apo të përhershëm, në zonën ku shtrin juridiksionin bashkia/komuna, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”;
- b) kryerjen e vlerësimit fillestar të të gjithë fëmijëve të referuar apo të identifikuar si fëmijë në rrezik;
- c) mbledhjen dhe koordinimin e takimeve të grupit teknik multidisiplinar;
- ç) hartimin dhe monitorimin e zbatimit të planit individual të mbrojtjes së fëmijës, të miratuar nga grupi teknik multidisiplinar;
- d) bashkëpunimin me njësinë e të drejtave të fëmijës në qark për menaxhimin e rasteve të veçanta të fëmijëve në rrezik, që nuk gjejnë zgjidhje nga aktorët që veprojnë brenda territorit të bashkisë/komunës;
- dh) propozimin në mënyrë aktive të ndërhyrjeve për të përmirësuar situatën e fëmijës në rrezik;
- e) organizimin e takimeve me partnerët e nevojshëm për menaxhimin e rasteve emergjente;
- ë) kryerjen e punës individuale me fëmijët e familjet dhe kryerjen e vizitave në familje;
- f) mbajtjen e të dhënave të sakta dhe aktuale të të gjithë fëmijëve të referuar/të identifikuar në njësinë për mbrojtjen e fëmijës dhe sigurimin e hedhjes së informacionit edhe në një sistem të dhënash të unifikuar;
- g) ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave për fëmijët;
- gj) mbledhjen në mënyrë periodike të tryezave me profesionistë dhe autoritete shtetërore përgjegjëse me qëllim:
 - vlerësimin e nevojave të fëmijëve dhe aktorëve të ndryshëm në terren;

- forcimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve dhe harmonizimin e ndërhyrjeve;
- organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në përputhje me nevojat e fëmijëve dhe komunitetit.
- h) dokumentimin dhe ndarjen me partnerët lokalë të praktikave pozitive;
- i) propozimin e përmirësimit të politikave sociale në nivel lokal dhe të shërbimeve për fëmijët në nevojë në këshillin e bashkisë/komunës.

15. Njësia për mbrojtjen e fëmijës paraqet raporte 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore në bashki/komunë, në Shërbimin Social Shtetëror Rajonal dhe Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Këto raporte përmbajnë informacion për rastet, në të cilat është ndërhyrë, për procedurat e ndjekura, masat e marra dhe problemet që janë konstatuar në territorin ku ajo shtrin juridiksionin e saj, duke paraqitur në raport edhe propozime konkrete për mbështetjen që kërkohet nga institucionet qendrore.

II. Procedura për ndërhyrjen, në ndihmë të fëmijëve në rrezik

1. Referimi në njësinë për mbrojtjen e fëmijës për një vlerësim nëse fëmija është në rrezik bëhet nga:

- a) fëmija;
- b) prindi ose kujdestari ligjor/përfaqësuesi ligjor i fëmijës;
- c) çdo person që vihet në dijeni të shkeljes të së drejtës për shkak të detyrës ose funksionit;
- ç) çdo person tjetër që ka lidhje farefisnore me fëmijën;
- d) çdo person fizik që vihet në dijeni lidhur me shkeljen e një të drejte të fëmijës;
- dh) një subjekt anonim.

2. Njësia për mbrojtjen e fëmijës fillon procedurën e kryerjes së vlerësimit, kur ka referime ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, duke marrë pëlqimin e fëmijës, prindit, kujdestarit apo përfaqësuesit ligjor të fëmijës.

3. Në rastet e veçanta të shkeljes të së drejtës së fëmijës, të bërë publike, njësia për mbrojtjen e fëmijës fillon procedurën e vlerësimit të çështjes me nismën e vet, edhe nëse nuk ka pasur referim nga subjektet e përcaktuara në nenin 1, të këtij kreu, apo kur kujdestari/përfaqësuesi ligjor i fëmijës nuk vepron. Njësia për mbrojtjen e fëmijës mund të kërkojë pëlqimin e fëmijës së dëmtuar, në rastet kur mosha dhe shkalla e pjekurisë së tij e mundësojnë këtë.

4. Hapat, që ndjek njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë, për menaxhimin e rastit të mbrojtjes së fëmijës janë, si më poshtë vijon:

- a) Identifikimi ose referimi i një fëmije te njësia për mbrojtjen e fëmijës;
- b) Vlerësimi fillestar i nivelit të rrezikut ndaj fëmijës;
- c) Marrja e vendimit për veprimet që do të ndërmerren nëse fëmija ndodhet në një situatë emergjente;
- ç) Vlerësimi i plotë i situatës së fëmijës;
- d) Mbledhja e grupit teknik multidisiplinar;
- dh) Hartimi dhe miratimi i planit individual për mbrojtjen e fëmijës;
- e) Ndërmarrja e veprimeve dhe ndërhyrjeve të punonjësit për mbrojtjen e fëmijës, autoriteteve të tjera shtetërore përgjegjëse dhe aktorëve të tjerë, në përputhje me planin individual për mbrojtjen e fëmijës;
- ë) Monitorimi i ecurisë së fëmijës, përmes takimeve të rregullta me fëmijën dhe vizitave në familje;
- f) Organizimi i takimeve të grupit teknik multidisiplinar për rishikimin e planit individual të mbrojtjes së fëmijës, në përputhje me nevojat në ndryshim të fëmijës dhe familjes;
- g) Hartimi i planit individual të rishikuar për mbrojtjen e fëmijës;
- gj) Ndërmarrja e veprimeve dhe ndërhyrjeve të punonjësit për mbrojtjen e fëmijës, autoriteteve të tjera shtetërore përgjegjëse dhe aktorëve të tjerë bazuar në planin individual të rishikuar për mbrojtjen e fëmijës;

h) Mbyllja e dosjes së fëmijës, kur ky i fundit nuk është më në rrezik.

5. Ministri, që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, miraton udhëzimin metodologjik, si dhe akte të tjera të nevojshme, për mënyrën e zbatimit të hapave për menaxhimin e rastit të mbrojtjes së fëmijës.



6. Në rastet e fëmijëve në rrezik, kur grupi teknik multidisiplinar harton një plan individual për mbrojtjen e fëmijës, por nevojat e rastit nuk adresohen plotësisht nga shërbimet ekzistuese, atëherë njësia për mbrojtjen e fëmijës njofton dhe kërkon bashkëpunimin e njësisë për të drejtat e fëmijës në nivel qarku, për mbledhjen e komitetit drejtues, sipas shkronjës “b” të pikës 5 të këtij vendimi.

7. Njësia për të drejtat e fëmijës në nivel qarku mbledh komitetin drejtues, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e njoftimit nga njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë.

8. Në rastin e mbrojtjes së fëmijës në rrezik, kur bashkia/komuna ku fëmija gjendet, nuk ka ngritur akoma njësinë për mbrojtjen e fëmijës, njësia për të drejtat e fëmijës në qark bashkëpunon me një nga njësitë për mbrojtjen e fëmijës brenda territorit të qarkut, me qëllim vlerësimin e situatës dhe ndjekjen e hapave për menaxhimin e rastit.

9. Fëmijë në situatë emergjente konsiderohet fëmija i cili nëse lihet në rrethanat aktuale, pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse, mund të vdesë, të dëmtohet ose të plagoset rëndë apo të jetë pre e keqtrajtimeve, të konsideruara vepër penale, sipas nenit 124/b të Kodit Penal, të ndryshuar.

10. Çdo fëmijë, që gjendet në situatë emergjente, do të merret në mbrojtje të menjëhershme nga strukturat e policisë, në bashkëpunim me njësinë për mbrojtjen e fëmijës dhe Shërbimin Social Shtetëror, edhe jashtë orarit zyrtar të punës.

11. Fëmijës në situatë emergjente i ofrohet në mënyrë të menjëhershme strehim, ushqim, kujdes shëndetësor dhe mbështetje ligjore.

12. Pas dhënies së ndihmës së menjëhershme, njësia për mbrojtjen e fëmijës vendos mbledhjen e anëtarëve të grupit teknik multidisiplinar, që janë më të nevojshëm për trajtimin e menjëhershëm të fëmijës, brenda 48 (dyzet e tetë) orëve.

III. Dispozita të përgjithshme

1. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, prefektët, kryetarët e këshillave të qarqeve, kryetarët e bashkive/komunave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 266, datë 12.4.2012

PËR BASHKËRENDIMIN E VEPRIMTARISË SË MEKANIZMAVE NË NIVEL QENDROR DHE VENDOR PËR ÇËSHTJET QË LIDHEN ME MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 32 pika 4 të ligjit nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

Në kuptim të këtij vendimi, ministritë përgjegjëse janë:

1. Ministria e Brendshme;
2. Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
3. Ministria e Drejtësisë;
4. Ministria e Shëndetësisë;
5. Ministria e Integritimit;
6. Ministria e Financave;
7. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

8. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
9. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 2

Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe ministrive përgjegjëse

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta bashkëpunon me ministritë përgjegjëse në përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, si dhe detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, nëpërmjet:

- a) hartimit dhe zbatimit të politikave, akteve ligjore/nënligjore, studimeve dhe projekteve të përbashkëta, për realizimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- b) informimin në rastet e konstatimit të shkeljeve të legjislacionit dhe raportimit pranë Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
- c) hartimit të udhëzimeve përkatëse lidhur me mënyrat dhe format e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve në nivel vendor me njësitë për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie/komune dhe njësitë për të drejtat e fëmijës në këshillin e qarkut.

Neni 3

Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (ASHMDF) me njësitë për mbrojtjen e fëmijëve/njësitë për të drejtat e fëmijëve në nivel komune/bashkie/qarku

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (ASHMDF) bashkëpunon me njësitë për të drejtat e fëmijës, në nivel qarku dhe njësitë e mbrojtjes së fëmijës, në nivel bashkie/komune, për të garantuar zbatimin e legjislacionit dhe të politikave shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, nëpërmjet:

- a) monitorimit të zbatimit të detyrave të këtyre strukturave, të përcaktuara në nenet 38 dhe 39 të ligjit nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”;
- b) rritjes së kapaciteteve të njësisë për të drejtat e fëmijës, në nivel qarku dhe njësisë për mbrojtjen e fëmijës, në nivel bashkie/komune, lidhur me zbatimin e të drejtave të fëmijëve dhe realizimin e ndërhyrjeve efektive, në bashkëpunim me aktorët lokalë, për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
- c) mbledhjes periodike të të dhënave statistikore, të përcaktuara në aktet nënligjore, të përpunuara nga njësia për të drejtat e fëmijës, në nivel qarku dhe njësia për mbrojtjen e fëmijës në nivel bashkie/komune, për gjendjen e të drejtave të fëmijës në territorin e qarkut, bashkisë/komunës;
- ç) shkëmbimit, çdo 6 muaj, të informacionit për aktivitetin e tyre, situatën e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në territorin e qarkut, bashkisë/komunës, problematikën, si dhe propozime konkrete për mbështetjen që kërkohet nga institucionet qendrore;
- d) rritjes së kapaciteteve të punonjësve dhe funksionarëve të administratës publike në institucionet shtetërore përgjegjëse në nivel vendor, lidhur me detyrimet institucionale në zbatim të kuadrit ligjor për realizimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, për funksionimin në mënyrë efektive të grupeve multidisiplinare, zbatimin e planeve individuale të mbrojtjes së fëmijëve në rrezik, vendosjen e një klime bashkëpunimi dhe reagimin e menjëhershëm për mbrojtjen e fëmijës në rrezik, dërgimin e të dhënave statistikore e informacionit të kërkuar;
- dh) orientimit të organizatave jofitimprurëse për mbështetjen e njësisë për të drejtat e fëmijës, në nivel qarku dhe njësisë për mbrojtjen e fëmijës, në nivel bashkie/komune në ushtrimin e funksioneve të tyre për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si dhe zbatimin e programeve dhe projekteve të përbashkëta që kanë në fokus mbrojtjen e fëmijëve në rrezik.



Neni 4

Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të ministrive përgjegjëse në nivel vendor me Njësinë për të Drejtat e Fëmijës në nivel qarku dhe Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës, në nivel bashkie/komune

Strukturat e ministrive përgjegjëse në nivel vendor bashkëpunojnë me Njësinë për të Drejtat e Fëmijës në nivel qarku dhe Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës, në nivel bashkie/komune, nëpërmjet:

a) identifikimit të problematikave lidhur me shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore, juridike, si dhe regjistrimin e fëmijëve në shërbimin e gjendjes civile, në nivel vendor dhe paraqitjen e tyre pranë njësive të qeverisjes vendore, duke propozuar nga këto të fundit mbështetje në rastet kur ajo është e nevojshme;

b) marrjes pjesë në takimet e grupeve multidisiplinare, në nivel bashkie/komune dhe të komitetit drejtues, në nivel qarku, me qëllim bashkërendimin e punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse në nivel vendor për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik;

c) kryerjes së trajnimeve dhe programeve të përbashkëta për kualifikimin e personave përgjegjës në këto struktura për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve;

ç) kryerjes së studimeve dhe projekteve të përbashkëta që synojnë evidentimin dhe/ose përmirësimin e gjendjes së zbatimit të të drejtave të fëmijëve në territorin e bashkisë/komunës/qarkut ku do të kryhet ky i fundit;

d) shkëmbimit të informacionit, të dhënave statistikore, si dhe çdo të dhëne tjetër dhe dorëzimit të këtyre të fundit te Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, sipas periodicitetit të përcaktuar në aktet nënligjore.

Neni 5

Dispozita përfundimtare

1. Ngarkohen ministrinë përgjegjëse për nxjerrjen e udhëzimeve dhe të akteve normative të brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 268, datë 18.4.2012

PËR KRYERJEN NË MËNYRË ELEKTRONIKE TË PROCEDURAVE KONKURRUESE TË DHËNIES SË KONCESIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 5 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Publikimi i dokumenteve të procedurave konkurruese të koncesionit dhe dorëzimi i ofertave të operatorëve në këto procedura do të zhvillohen me mjete elektronike.

2. Ngarkohet Agjencia e Prokurimit Publik të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 269, datë 18.4.2012

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 27, DATË 19.1.2007 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË VLERËSIMIT DHE
TË DHËNIES SË KONCESIONEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 5 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin “Rregullat e vlerësimit dhe dhënies së koncesioneve” që i bashkëlidhet vendimit nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 “Për propozimet e kërkuara” të kreut III “Organizimi i procedurave konkurruese të përzgjedhjes”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në shkronjën “a” paragrafi i fundit, pas shprehjes “... ftesë për ofertë ...” shtohet fjalia “... Në rast se publikimi i dokumenteve dhe depozitimi i ofertave bëhet me mjete elektronike, botimi i ftesës për ofertë do të bëhet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe shpallja e dokumenteve të procedurës në platformën elektronike të prokurimeve, në adresën zyrtare elektronike të APP-së.”.

b) Në shkronjën “d”, paragrafi i parë, pas shprehjes “... të institucionit përgjegjës (qendror apo vendor) për dhënien e koncesionit, në *web-siten*-n e APP-së ...” shtohet fjalia “... Në rast se publikimi i dokumenteve dhe depozitimi i ofertave bëhet me mjete elektronike, botimi i tyre do të bëhet në platformën elektronike të prokurimeve, në adresën zyrtare elektronike të APP-së ...”.

2. Paragrafi i parë i pikës 1 të kreut IV “Dokumentet standarde të procedurës konkurruese” ndryshohet si më poshtë vijon:

“Autoriteti kontraktues përgatit formatin e dokumenteve standarde të procedurës konkurruese që do të përdoret gjatë procedurave të konkurrimit. Në rast se publikimi i dokumenteve dhe depozitimi i ofertave bëhet me mjete elektronike, këto dokumente duhet të publikohen në platformën elektronike të prokurimeve në adresën zyrtare elektronike të APP-së, sipas udhëzimeve të APP-së dhe nënkuptojnë ...”.

3. Në pikën 2 të kreut VI “Hartimi i dokumenteve të procedurës konkurruese” bëhen këto shtesa:

a) Në fund të paragrafit të parë shtohet fjalia: “Në njoftim shënohet edhe se dokumentet e procedurës konkurruese mund të sigurohen në rrugë elektronike nga adresa zyrtare elektronike e APP-së.”.

b) Në fund të paragrafit të dytë shtohet fjalia: “Në rast se publikimi i dokumenteve dhe depozitimi i ofertave bëhet me mjete elektronike edhe shtojca e modifikimeve vihet në dispozicion në rrugë elektronike.”.

4. Në pikën 2 “Dorëzimi i ofertave” të kreut VII “Paraqitja dhe dorëzimi i ofertave”, në fund të paragrafit të katërt shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në rast se publikimi i dokumenteve dhe depozitimi i ofertave do të bëhet me mjete elektronike, dorëzimi i ofertave të operatorëve do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 271, datë 18.4.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 231, DATË 11.5.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL DHE PERIUdhËN E PROVËS”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 17 e vendimit nr. 231, datë 11.5.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“17. Pikët maksimale të mundshme janë:

- a) 70 pikë për rezultatin e testimit me shkrim;
- b) 10 pikë për përvojën në punë të kandidatit dhe kualifikimet afatshkurtra;
- c) 12 pikë për diplomën e programeve “Studime specializuese afatgjata” specializimet apo kualifikimet postmaster apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe njohjes, rast pas rasti, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;

ç) 8 pikë për aftësitë e veçanta personale.

Kandidatët me gradën shkencore “Doktor” vlerësohen me pikët maksimale të testimit me gojë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 272, datë 18.4.2012

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS
LUKOVË, TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Lukovë, të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes nr. 1 e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Lukovë, të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr. 761, datë 28.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Lukovë, të qarkut të Vlorës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Lukovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Lukovë		Lidhja nr. 1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-4, 6-15	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
16-20,37	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
21-34	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
82-91	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
53-61	Varrezat publike	Në pronësi
62-81	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.	Në pronësi
92-94, 96-98	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim Nuk transferohet sipërfaqja prej 302 ha tokë bujqësore, dorëzuar AKKP-së, në zbatim të VKM-së nr.868, datë 18.6.2008
95, 99-101	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi
292-303, 306	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
307-319	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM
Nr. 273, datë 18.4.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS PISHAJ, TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Pishaj, të qarkut të Elbasanit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 186 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi përfundon me numrin rendor 1273 (një mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Pishaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Komuna Pishaj

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-3	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
10-33	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
34, 36-40	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
42-45	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
46, 47, 50	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
51-59, 62-70	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
79-111	Varrezat publike	Në pronësi
246-270, 273-303, 305-376, 378-382, 384-396, 399-404, 406-407, 409, 1193, 1207	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
410-422, 424-440, 442, 443, 445-474, 478, 480-500, 502-514, 516-519, 1208-1209	Infrastrukturë (rrugë vendore).	Në pronësi
564, 565, 569-571, 575-577, 582-584, 588-591, 594-596, 601, 605-607, 611-613, 617-619, 623-626, 631, 635, 641-642, 644-646, 648-649, 653-659	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim Nuk transferohet sipërfaqja 241 ha, shtrihet në fshatin Pishaj, Çekin, Kocaj, Cërroje, Qerret dhe është dorëzuar në AKKP
566-568, 572-574, 578-581, 585-587, 592-593, 598-600, 602-604, 608-610, 614-616, 620-622, 627-630, 632-634, 636-640, 650-652, 660-662, 663-762 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
1088	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM

Nr. 274, datë 18.4.2012

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS HYRËSE TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE BILAJ, NË KOMUNËN E BUBQIT, TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5/1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës hyrëse të shkollës 9-vjeçare Bilaj, në komunën e Bubqit, të qarkut të Durrësit.

2. Pasuritë, në sipërfaqen prej 534 (pesëqind e tridhjetë e katër) m² tokë arë, pronë private, që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen, janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij projektvendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, është 124,

422 (njëqind e njëzet e katër mijë e katërqind e njëzet e dy) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e komunës së Bubqit, planifikuar në buxhetin e saj.

4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga komuna e Bubqit.

6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga komuna e Bubqit, për realizimin e këtij projekti.

7. Shpronësimi bëhet në favor të komunës së Bubqit. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 534 (pesëqind e tridhjetë e katër) m² tokë arë, shpronësuar në favor të komunës së Bubqit, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen komuna e Bubqit dhe Ministria e Brendshme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E RRUGËS HYRËSE TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE BILAJ, NË KOMUNËN E BUBQIT, QARKU DURRËS

Nr.	Emër, mbiemër	Sip. arë m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë	Numri i pasurisë	Zona kadastrale	Dok. i pronësisë
1	Bib Shota	534	233	124 422	77/24	1185	Certifikatë pronësie
	TOTALI	534		124 422			

VENDIM
Nr. 275, datë 18.4.2012

PËR DHËNIEN E LEJES SË HYRJES DHE TË QËNDRIMIT TË PËRKOZHSHËM NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË NJË FORCE USHTARAKE AMERIKANE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e hyrjes dhe të qëndrimit të përkohshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë të një force ushtarake amerikane, të përbërë nga 685 (gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë) trupa, ekuipazh i anijes ushtarake zbarkuese të Shteteve të Bashkuara të Amerikës “USS GUNSTON HALL” (LSD-44).

2. Hyrja, qëndrimi dhe dalja e forcës ushtarake amerikane bëhet në portin e Durrësit.

3. Leja e hyrjes dhe qëndrimit të përkohshëm të forcës ushtarake amerikane jepet për periudhën 24 prill 2012 deri në 27 prill 2012.

4. Qëllimi i qëndrimit të përkohshëm të kësaj force ushtarake amerikane është për vizitë portuale.

5. Trupat amerikane gjatë hyrjes, qëndrimit dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë do të kenë statusin e parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951 dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 10 101, datë 26.3.2009, si dhe statusin e parashikuar në marrëveshjen plotësuese ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të



Amerikës, të marrëveshjes mes shteteve palë në Traktin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe lidhur me statusin e forcave të tyre “Mbi statusin e forcave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Shqipërisë”, nënshkruar në Tiranë më 31.3.2004 dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 9246, datë 24.6.2004.

6. Gjatë hyrjes, qëndrimit dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë trupat amerikane të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 276, datë 18.4.2012

PËR DISA SHTESA NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 256, DATË 12.3.2009 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË KOMUNËS PAJOVË, TË QARKUT ELBASAN” DHE NR. 988, DATË 2.7.2008 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PYJEVE DHE KULLOTAVE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KOMUNËS PAJOVË TË QARKUT ELBASAN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme të tipit pyje dhe kullota në territorin administrativ të Komunës Pajovë, të Qarkut Elbasan. Lista është me 1 (një) fletë dhe përfundon me numrin rendor 11 (njëmbëdhjetë).

2. Miratimin e listës shtesë të pronave të tipit pyje dhe kullota që transferohen në pronësi të komunës Pajovë, të qarkut Elbasan. Lista është me 1 (një) fletë dhe përfundon me numrin rendor 21 (njëzet e një).

3. Ndryshimet në listën e inventarit dhe në listën përfundimtare të pyjeve dhe kullotave, që transferohen në pronësi, si dhe lidhja nr. 1 (një) i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Pajovë e qarkut Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore: Pajovë, qarku Elbasan

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
71-72, 74-2, 79, 81, 83, 87, 89	Pyll, sipërfaqe me bimësi pyjore	Pronësi
91-92, 183-188, 190-193	kullotë	

VENDIM
Nr. 277, datë 18.4.2012

**PËR AUTORIZIMIN E “AMA RECYCLING”, SHPK PËR IMPORTIN E MBETJEVE
METALIKE TË ALUMINIT DHE TË BAKRIT, PËR QËLLIME RICIKLIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 22 pika 3 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të nenit 49, pika 2 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e “AMA RECYCLING”, sh.p.k. për importin e mbetjeve metalike e aluminit dhe të bakrit për qëllime riciklimi, me kodin GA 760200 740400 dhe B1-B1010, të Konventës së Bazelit, anekset 1 e 2, “Mbetjet e listës së gjelbër” referuar vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 825, datë 13.10.2010 “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, si më poshtë vijon”:

- GA 760200, mbetje dhe kthime të aluminit;
- GA 740400, mbetje dhe kthime të bakrit.

2. Sasia e mbetjeve metalike të aluminit dhe të bakrit që importohet sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi është 7 000 (shtatë mijë) tonë.

3. Mbetjet importohen nga Italia, Mali i Zi dhe Kosova. Transporti bëhet në rrugë tokësore, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe të procedurave për importimin e mbetjeve për përpunimin dhe riciklimin”. Ambalazhimi i tyre do të bëhet në paleta, i presuar ose në thasë plastikë, konform aneksit III të vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”. Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve “AMA RECYCLING” sh.p.k. dorëzon të plotësuar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në aneksin IV të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 825/2010 dhe monitorimi i tyre do të kryhet nga strukturat përkatëse të doganave. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me raport-analizë, të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

4. Periudha e lejimit të importit të mbetjeve metalike të aluminit dhe të bakrit nga “AMA RECYCLING”, sh.p.k. do të jetë për një periudhë kohore njëvjeçare që do të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore, merr masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve metalike të aluminit dhe të bakrit nga “AMA RECYCLING”, sh.p.k. pas miratimit të këtij vendimi, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon me shkrim me shtetet eksportuese dhe ato që dalin transit të kësaj sasive të mbetjeve metalike të aluminit dhe të bakrit në përmbushje të kërkesave të konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimit të tyre” në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 18.5.2012
Doli nga shtypi më 21.5.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 40 lekë